

Materiale shtesë për njësinë mësimore 3:

BAZAT E GAZETARISË DHE PRODUKSIONI MEDIATIK

Detyrë (për vitin I): Roli i gazetarëve në shoqëri

Metodologji e rekomanduar

Tregimi gazetaresk që është shpërblyer në konkursin për storje më të mirë hulumtuese të Institutit Maqedonas për Media (burimi: http://98.130.153.42/index.php?option=com_content&view=article&id=163&Itemid=90&lang=mk)

Diskutim: Nxënësit i lexojnë storjet sipas radhitjes së shpallur kronologjike. Pastaj diskutojnë në këto pyetje: Me çka lidhet tregimi? Si ka qenë gjendja para ose në kohën kur tregimi është publikuar? Si ka ndryshuar gjendja derisa është raportuar për ngjarjen? Çka ka ndryshuar pasi është publikuar tregimi në media?

Detyrë (për vitin II): Gjuha dhe mediat

Shembull: Analizë gazetave, emisioneve të radios dhe të televizionit ose ueb-faqeve.

Diskutim: Nxënësit mund të analizojnë:

- tekste në gazeta ditore
- kontribute në lajme ose në emisione të radios dhe të televizionit
- tekste në ueb-faqet e gazetave ose të televizioneve dhe të gjejnë gabime në shkrimet gazetareske.

Detyrë (për vitin II): Burimet e informimit

Metodologji e rekomanduar për vitin II

Shembull - Nxënësit kërkojnë informacione.

Diskutim - Secili nxënës merr nga një fletë me një numër të caktuar pyetjesh (të ndryshme për çdo nxënës). Për shembull:

1. Sa kushton një vit studime private në Shkollën e Lartë të Gazetarisë dhe të Marrëdhënieve me Publikun në Shkup?
2. Sa është lartësia e dënimit për vrasje nga pakujdesia?
3. Gjithsej, sa pjesëtarë të forcave të sigurisë humbën jetën në konfliktet e vitit 2001?
4. Cili është çmimi i një kapuçinoje në kafiterinë “...” në ...?
5. Kush është drejtori i parë i gazetës “Nova Makedonija”?
6. Në sa metra prej detit është pika më e lartë e urës “Golden Gejt” në San-Francisko?

Çdo e dhënë duhet të konfirmohet nga dy burime të pavarura. Nxënësit mund të shfrytëzojnë njerëz, telefona, arkiva, internetin...

Detyrë (për vitin III): Si shkruajnë gazetarët?

Metodologji e rekomanduar

Shembull - Nxënësit përpilojnë raport gazetaresk.

Diskutim - Nxënësve u jepet shembulli i mëposhtëm. Ata duhet të përpilojnë një raport gazetaresk sipas rregullave për strukturimin e tekstit nga këta paragafë:

- Në Republikën e Maqedonisë do të mbahet manifestimi “VINOSKOP”.
- Në 11 pika janë distribuar gota të qelqit, të cilat shiten nga 70 denarë.
- Këtë vit nuk do të ftohen enologë nga jashtë për vlerësimin e cilësisë së verës, për shkak të mungesës së mjeteve financiare.

- Në stendat e vëna në kejin “13 Nëntori“ do të bëhet degustacioni i ushqimit. Do të ketë çdo lloj mishrash të thatë. Mish të përgatitur në prush. EKSKLUZIVITET më i madh do të jetë DEMI NË PRUSH.

- Ata që i duan verërat, dje kishin mundësi që në Sheshin Maqedonia dhe para kejit të Vardarit nga ora 18 t'i provojnë verërat e njohura nga bodrumet më të njohura maqedonase të verës.

- Kryetari i Qytetit, Koce Trajanovski, do ta hapë manifestimin, vendi i të cilit do të jetë në pjesën më të madhe të Sheshit Maqedonia, si dhe në kejin “13 Nëntori”.

- Në VINOSKOP 2009 përveç verërave të njohura, në fundjavë qytetarët kanë mundësi të marrin pjesë në argëtimet e mëdha, të cilat i organizon Qyteti i Shkupit.

- Çmimet për të mbushur një gotë verë sillen nga 50 - 230 denarë, varësisht nga cilësia e saj.

- Në kuadër të pjesës muzikore të programit, shkupjanët do t'i argëtojnë më shumë interpretues të njohur nga vendi dhe bota - Sintezis, Bakllava, Ruah nga Polonia, Tricidirona nga Italia etj.

- Shumë të pranishëm, për shkak të temperaturave të ulëta, ngrenë dolli edhe me verë të ngrohur.

- Çmimet për të mbushur një gotë verë sillen nga 50 - 230 denarë.

- “Ky është një manifestim i rrallë, i cili në një vend mbledh më shumë bodrume të verës dhe është një mundësi e mirë për zhvillimin e turizmit”, tha njeriu i parë i Shkupit, Koce Trajanovski.

- Fimka Temova premtoi se në manifestim do të ketë shumë verë, muzikë dhe shpërblime, të cilat për çdo ditë do të ndahen në stendat ”Skovin” në periudhën nga ora 23:00 deri në orën 23:30.

- Adrenalinin e dafrungës 4-ditore me verë e ushqim do ta ngrenë një numër i madh interpretuesish të muzikës nga vendi dhe bota. Mini-koncert do të mbajnë Sintezis, si dhe Cikibum nga Spanja, Tolga nga Italia etj.

- Për më të rinjtë do të ngrihen kënde fëmijësh, me piktorë dhe zbavitës të ndryshëm, ndërsa do të ekspozohen edhe punime dore nga periudha e mesjetës me pricesha, princër, pastaj do të organizohen gara në qitje e të ngjashme.

- Tashmë, që tre vjet me radhë, krahas tendave me verë, do të ketë edhe çka të hahet edhe çka të shihet.

- Pjesa e ushqimeve është e vendosur në kejin e Vardarit, ku edhe do të shërbehet.

- Prodhuesi i verërave Fonko ofron 15 verëra, me të cilat kanë marrë medalje të arta dhe të argjendta në festivale në Gjermani dhe në Kanada.
- Nga prodhuesit e jashtëm të verës sidomos theksohet "Fantinel" nga Italia, e specializuar për prodhimin e verërave të bardha, me çmime diçka më të shtrenjta, nga 400 deri në 1.500 denarë për shishe.
- Vizitorët do të kenë mundësi që në gara të ndryshme të fitojnë verëra tradicionale maqedonase nga standat e shtruara.
- Nga data 15 deri 18 tetor për herë të tretë do të mbahet manifestimi "VINOSKOP".
- Prodhuesi i verërave Fonko do të paraqitet me 15 lloje të verërave cilësore të vendit, i cili shpeshherë është shpërblyer në tregjet e jashtme. Në garat e organizuara në Kanada, në vitin 2008, ata janë paraqitur me verën Shardone dhe kanë marrë medaljen e argjendtë.
- Çmimet e verërave të tyre shkojnë prej 250 deri në 400 denarë për shishe.
- Me verë cilësore maqedonase u paraqitën edhe nga shtëpia e verës Dalvina nga Strumica, e cila këtë vit paraqitet për herë të parë para opinionit maqedonas.
- Për ata me xhep më të thellë, këtu është edhe prodhuesi italian i verës Fantinel, i cili në tregun maqedonas u paraqit para disa muajve dhe është i specializuar për verëra të bardha.
- Te ne çmimi është diçka më i lirë dhe shkon prej 200 deri në 300 denarë për shishe.
- Koha e ftohtë do të nxehet me muzikë dhe lojë.